



01-1964

Në bazë të dispozitave të nenit 21,22,44 dhe nenit 132 paragrafi 4 dhe 5 të Ligjit nr. 05/L-031 për Procedurën e Përgjithshme Administrative (Gazeta Zyrتare e Republikës së Kosovës nr. 20/21 qershori 2016), nenit 21 të Ligjit për Planifikimin Hapësinor Nr. 04/L-174 dt. 23.08.2013, Udhëzimit Administrativ MMPh Nr. 08/2017 për Normat Teknike të Planifikimit Hapësinor, nenit 18 të Ligjit për Ndërtim Nr.04/L-110 dt. 31.05.2012, nenit 17, pika "d" të Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale Nr.03/L-040 dt.20.02.2008, nenit 15 pika "d" e Statutit të Komunës së Prishtinës Nr.110-391 dt. 25.02.2010, Udhëzimit Administrativ të MMPh-së Nr.06/2017 dt.23.05.2017 për caktimin e procedurave për përgatitjen dhe shqyrtimin e kërkesave për kushte ndërtimore, leje ndërtimore dhe leje rrënimi për kategorinë e I-rë dhe të II-të të ndërtimeve dhe në bazë të kërkesës për riaplikim me nr. **05-350/03-238415/19 dt. 27.09.2019** të Flamur Ajvazi, Rr. Labëria, lagja "Kalabria" Prishtinë, për caktimin e kushteve ndërtimore për hartimin e dokumentacionit ndërtimor për ndërtimin e shtëpisë në bllokun "L-18" të tërësisë urbane "L", të Planit Rregullues "Prishtina e Re-Zona Perëndim" në Prishtinë, Drejtoria e Urbanizmit e Komunës së Prishtinës, në procedurë administrative, me datë 24.01.2020, merr këtë:

V E N D I M
PËR CAKTIMIN E KUSHTEVE NDËRTIMORE

I. I caktohen kushtet ndërtimore Flamur Ajvazi, sipas kërkesës për riaplikim me nr. **05-350/03-238415/19 dt. 27.09.2019**, për hartimin e dokumentacionit ndërtimor/projektit ideor për ndërtimin e shtëpisë për banim individual me etazhitë B+P+1, në kuadër të parcelës ndërtimore "L-18-7" dhe "L-18-8" të bllokut urban "L-18" të tërësisë urbane "L", të Planit Rregullues "Prishtina e Re-Zona Perëndim" në Prishtinë, në parçelen kadastrale nr. 00294-11 dhe 00294-12, Z.K Çagllavicë.

II. Lokacioni, i parcelës kadastrale të lartëcekur, për të cilin caktohen kushtet ndërtimore, gjendet në kuadër të Planit Rregullues "Prishtina e Re-Zona Perëndim", i miratuar me Vendimin e Komunës së Prishtinës 01 nr. 35-186850 dt. 02.10.2013, dhe sipas këtij plani kjo zonë është e paraparë për ndërtim individual. Lidhur me këtë dhe me parametrat e ndërtimit nga ky plan, pronari është informuar me "Informim nga Plani Rregullues "Prishtina e Re-Zona Perëndim", përmes sistemit online, me nr. të referencës 2353 të dt.24.07.2019.

III. Gjendja ekzistuese e lokacionit - parcelës kadastrale të trajtuar, sipas gjendjes kadastrale, faktike dhe dokumenteve të planifikimit hapësinor, është:

- Numri, sipërfaqja, pronari dhe klasa e kualitetit të parcelës kadastrale, është:
 - nr. 294-11, me S= 505 m², me pronar Flamur Ajvazi, "tokë bujqësore e klasës IV-të".
 - nr. 294-12, me S= 523 m², me pronar Flamur Ajvazi, "tokë bujqësore e klasës IV-të".
 - Gjithësejt dy parcelat kanë 1028,00m²
- E drejta pronësore-juridike është private, në bazë të kopjes së planit dhe certifikatës së njësisë kadastrale;
- Parcelat kadastrale nr. 294-11 dhe nr. 294-12, shtrihen në dy parcela ndërtimore (L-18-7 dhe L-18-8) të parapara sipas planit të riparcelimit, në kuadër të Planit Rregullues "Prishtina e Re-Zona Perëndim".
- Sipas Planit Rregullues "Prishtina e Re-Zona Perëndim" vija rregulluese përputhet me kufirin e parcelave të lartëcekura.
- Është tokë urbane, me infrastrukturë: rrugë, ujë, kanalizim, elektrikë, etj.;
- Terreni ka një ramje të lehtë në raport me rrugën;
- Parcata kadastrale ka qasje në rrugën ekzistuese dhe rrugën e planifikuar sipas këtij Plani Rregullues;



- Qasja e parcelës deri në rrugën kryesore publike arrihet përmes rrugës ekzistuese në terren.
- Në diametër prej 50 m' ka ndërtesa të ndërtuara dhe destinimi i tyre është banim individual.
- Parcelsa kadastrale me nr. 294-11, sipas planit të riparcelimit shtrihet në parcelën ndërtimore "L-18-8" ndërsa parcela kadastrale nr.294-12 në parcelën ndërtimore "L-18-7" të bllokut urban "L-18" të tërësisë hapësinore "L", të Planit Rregullues "Prishtina e Re-Zona Perëndim" në Prishtinë. .

IV. Kushtet ndërtimore për hartimin e dokumentacionit ndërtimor / projektit ideor, për rregullimin e hapësirës dhe realizimin – ndërtimin e shtëpisë individuale të banimit, bazuar në parametrat urban të planit, janë:

- Vija ndërtimore ndaj vijës rregulluese, gabariti i ndërtesës, pozicionimi i objektit dhe kushtet tjera për rregullimin e parcelës ndërtimore, të jenë në tërësi sipas Planit Rregullues "Prishtina e Re-Zona Perëndim" dhe sipas prezantimit grafik të përshkruar në dispozitën urbanistike në përpjesë 1:500, e që është pjesë përbërëse e këtyre Kushteve Ndërtimore;
- Etazhiteti maksimal i objektit të jetë P+2, i propozuar B+P+1.
- Indeksi i shfrytëzimit të parcels (ISHP) duhet të jetë 40% e sipërfaqes së parcels ndërtimore.Në rastin konkret 40% e parcels ndërtimore të propozuar për bashkim.
- Indeksi i sipërfaqes së përgjithshme ndërtimore (ISPN) të jetë max. 450 m²;
- Indeksi i shfrytëzimit të nëntokës (ISHN) duhet të jetë 60%;
- Indeksi i sipërfaqes së gjelbërimit (ISGJ) duhet të jetë 25%;
- Destinimi i shfrytëzimit të objektit të jetë për banim individual;
- Qasja në objekt duhet të jetë nga rruga lokale ekzistuese, njëkohësisht rrugë e planifikuar sipas Planit Rregullues;
- Distanca më e vogël nga parcela fqinje është 3.0 m`;
- Terasat, shkallët e jashtme, ballkonet, konzollat, etj., nuk mund të ndërtohen në distancë më të vogël se 3.0 m` nga parcela fqinje;
- Kuota e nivelit të përdhesës 0.45 m mbi nivelin e trotuarit;
- Në një parcelë ndërtimore, përveç ndërtesës kryesore, mund të ndërtohen edhe objektet ndihmëse që formojnë tërësi banimi apo tërësi ekonomike (si p.sh. garazhat, etj);
- Në kuadër të objektit ose parcels ndërtimore të parashihen dy garazha apo dy vendparkingje.
- Rrethojat kryesish duhet të jenë transparente apo rrethoja të gjelbra. Baza e rrethojës nuk duhet të jetë më e lartë se 50cm, mund të jetë nga betoni, tulla apo guri. Pjesa e rrethojës mbi bazë duhet të ndërtohet me materiale të lehta sikur druri, metali apo diçka e ngjashme. Rrethoja përskaj rrugës ka lartësi prej max 1.5 m,ndërsa në kufi me parcelën fqinjë mund të jetë max 2.0 m;
- Arkitektura e objektit të ri ti përshtatet ambientit që e rrethon, vlerave ambientale, duke pasur kujdes në harmonizimin e vertikalitetit dhe horizontalitetit të volumit të ndërtesës dhe me karakteristika të kulturës urbane;
- Zgjidhja e kulmit duhet të projektohet dhe të ekzekutohet ashtu që uji i strehëve duhet të pikojë brenda parcels kadastrale;

V. Bashkimi/ i parcelave kadastrale nr. 294-11 dhe nr. 294-12 Z.K Çagllavicë, do të realizohet sipas zgjidhjes urbane, të miratuar me këto kushte ndërtimore, përcaktuar me manualin e bashkimit punuar nga gjedjeti i licencuar.

Kjo drejtori përmes këtij paragrafi të vendimit të kushteve ndërtimore jep PËLQIM për bashkimin e parcelave kadastrale të lartëcekura , sipas zgjidhjes urbane.Procedura e bashkimit , do të realizohet bazuar në pëlqimin e konfirmuar në këtë paragraf, i cili do të shërbejë si bazë për evidentimin në regjistrin kadastral, të këtyre ndryshimeve.Procedura e bshkimit të bëhet para aplikimit për leje ndërtimore, në Drejtorinë e Kadastrit të Komunës së Prishtinës, sipas këtyre kushteve ndërtimore dhe me kërkesë të pronarit duke u bazuar në Planin e situacionit - "Zgjidhjen Urbane".

IV.Kyçja në infrastrukturë - marrja e pëlgimeve nga KEDS-i dhe KUR "Prishtina", bëhet me aplikim nga kjo drejtori. Për aplikim nevojitet prezantimi i dokumentacionit, me përcaktim të vendeve për kyçje në rrjetet përkatëse, dorëzuar veçantë në CD, me përbajtje si në vijim:

- Emri (prindi) mbiemri i aplikuesit dhe numri i identifikimit dhe adresa;
- Informatën mbi lokacionin-adresa e saktë e hapësirës ndërtuese;
- Kopjen e planit dhe certifikatën e njësisë kadastrale;
- Planin e situacionit (dispozita urbanistike pjesë përbërëse e kushteve ndërtimore) dhe pamjen në ortofoto të lokacionit me hapësirën ndërtuese;
- Përshkrimin teknik të objektit (destinimi dhe kapaciteti i nevojshëm për elektrike dhe ujë).

Kyçja në infrastrukturë për ngrohje qendrore të bëhet në rrjetin ekzistues, pas sigurimit paraprak të kushteve detale dhe pëlqimit për kyçje nga “Termokos”-Ngrohtorja e Qytetit sh.a. dhe PTK.

VI. Dokumentacioni ndërtimor - projekti kryesor, të hartohet nga ekipi me përgatitje të lartë profesionale dhe me kualifikime përkatëse për secilën fazë të projektit, duke u bazuar në kushtet ndërtimore të caktuara në pikën IV, projekt propozimin e prezantuar, normave tekniqe për siguri nga zjarri si dhe normave dhe standardeve tjera për projektim të kësaj kategorie të ndërtesave, të dorëzohet në tre (3) kopje të shtypura, dhe një (1) digjitale dhe të përmbytë:

- Lokacionin e parcelës ndërtimore në kuadër të zonës;
- Planin e situacionit të gjërë, në diametër prej 50m` , me ndërtesat ekzistuese dhe të planifikuara, në përpjesë 1:500 apo 1:1000, punuar në bazë të incizimit gjeodezik të parcelës ndërtimore me rrithinë, si dhe me pozicionim të ndërtesës së projektuar dhe infrastrukturës rrugore, në sistemin koordinativ KOSOVAREF 01;
- Planin e situacionit të parcelës, në përpjesë 1:200 ose 1:500, me dimensione të shënuara, horizontale dhe vertikale-kuota të lartësisë dhe me pozicionim të ndërtesave në sistemin koordinativ KosovaREF01, duke përfshirë edhe kuotat vertikale të hyrjeve në përdhesë, me kuota të shënuara, relative dhe absolute;
- Incizimin gjeodezik të parcelës ndërtimore me rrithinë, si dhe me pozicionim të ndërtesave të projektuar dhe infrastrukturës rrugore, në sistemin koordinativ KOSOVAREF 01;
- Të gjitha bazat, prerjet dhe dukjet e fasadave, në përpjesë 1:50, për ndërtesën e projektuar, duke përfshirë edhe kuotat vertikale të hyrjeve në përdhesë dhe etazheve tjera, me kuota të shënuara, relative dhe absolute;
- Detajet karakteristike dhe të nevojshme, në përpjesë 1:5,1:10 apo 1:20 dhe specifikimin e zdrukthëtarisë, me përshkrimin e materialit të dyerive dhe dritareve, në përpjesë 1:50;
- Përshkrimin teknik të punëve ndërtimore
- Paramasën dhe paralogarinë e punëve ndërtimore;
- Projektin e organizimit të kompleksit, me sinjalizime përkatëse të komunikacionit dhe lidhja-qasja e saj me rrugët dhe komplekset në rrithinë, etj.;
- Projektin e strukturës së ndërtimit-llogarinë statike, me përshkrim teknik, pozicionimin dhe detajet e nevojshme;
- Projektin e instalimeve elektrike, me përcaktimin e vendit për kyçje në rrjetin energjetik të qytetit dhe pozicionimin e trafostacionit;
- Projektin e instalimeve hidroteknike, me përcaktimin e vendit për kyçje në rrjetin e qytetit;
- Projektin e instalimeve të makinerisë, me përcaktimin e vendit për kyçje në rrjetin e qytetit;
- Elaborati i "Organizmi dhe masat e sigurisë në vend ndërtim", bazuar në Vendimin 01nr.035-174324 dt.12.07.2016, e Kryetarit të Komunës së Prishtinës;
- Elaboratin e fizikës ndërtimore (akustika, termika, masat për eficiencë të energjisë);
- Elaboratin gjeomekanik, në bazë të analizave të terrenit;

VII. Pagesa e kompensimit për ndërrimin e destinimit të tokës bujqësore - meqenëse parcela kadastrale nr. 294-11 dhe nr. 294-12 Z.K Çagllavicë në bazë të çertifikatës së njësisë kadastrale, janë të evidentuara me lloj të shfrytëzimit të parcelës-tokë bujqësore, me klasë të kualitetit “IV”, kërkohet që paraprakisht të bëhet pagesa e kompensimit për ndërrimin e destinimit të tokës pyjore në tokë ndërtimore, konform nenit 11, 13 dhe 14 të Ligjit nr. 02/L-26 për Tokën Bujqësore dhe nenit 8, 9 dhe 14 të Udhëzimit Administrativ të MBPZHR Nr. 41/2006, për ndërrimin e destinimit të tokës bujqësore, që e rregullojnë këtë fushë.

Sipërfaqja e tokës bujqësore, të cilës do ti ndërrohet destinimi, do të përcaktohet bazuar në sipërfaqen që do të ndërtohet, sipas Planit të situacionit – “zgjidhja urbane”, duke llogaritur sipërfaqen e parcelës ndërtimore, brenda vijës rregulative të përcaktuar me Planin rregullues. Kjo sipërfaqe do të registrohet si

tokë ndërtimore, në regjistrin kadastral, pas realizimit të pagesës së kompensimit për ndërrimin e destinimit të tokës bujqësore,

Ky kompensim - pagesë do të realizohet në Drejtorinë e Kadastrit të Komunës së Prishtinës, në fazën e zhvillimit të procedurës administrative përmarrjen e lejes ndërtimore.

VIII. Marrëveshja për infrastrukturë – bazuar në nenin 23 të Ligjit Nr.04/L-110 për Ndërtim dhe në nenin 10 dhe 11 të “Rregullore mbi Taksën administrative për dhënien e lejes së ndërtimit dhe Tarifën për rregullimin e infrastrukturës” 01 nr. 434/01–0094474/17 dt. 24.04.2017, obligohet Drejtoria e Investimeve Kapitale dhe Menaxhimit të Kontratave e Komunës së Prishtinës, të vlerësojë një ngarkesë për të rimbursuar koston për krijimin, përmirësimin, zgjerimin apo riparimin e infrastrukturës, dhe të arrijë marrëveshje për infrastrukturë me pronarin. Me aplikacionin për leje ndërtimore të dorëzohet dokumentacioni i nevojshëm, në dosje të veçantë, i cili përmes aktit përcjellës, do të procedohet, nga kjo drejtori, në kompetencë të Drejtorisë së Investimeve Kapitale dhe Menaxhimit të Kontratave të Komunës së Prishtinës, përrritjen e kësaj marrëveshjeje. Dokumentacioni i përgatitur duhet të përbajë:

- Dëshminë mbi pronësinë për parcelën kadastrale/certifikatën e njësisë kadastrale dhe kopjen e planit (kopje);
- Vendimi për caktimin e kushteve ndërtimore, së bashku me situacionin e miratuar, të lëshuar nga kjo drejtori;
- Autorizimin përfaqësim (nëse është prezantuar në kërkesën e lejes ndërtimore);
- Kopjen e letërnjoftimit të aplikuesit.

IX. Pagesa e taksës administrative për dhënien e lejes së ndërtimit dhe tarifa për ndikimet nga rritja e densitetit të infrastrukturës, do të realizohet sipas “Rregullores mbi Taksën Administrative për dhënien e lejes së ndërtimit dhe Tarifën për rregullimin e infrastrukturës” 01Nr.434/01 – 0094474/17 dt.24.04.2017 dhe bazuar në dokumentacionin ndërtimor / projektin ideor, si pjesë përbërëse e kërkesës për leje ndërtimore. Pagesa e taksës dhe tarifës, sipas këtij paragrafi, do të realizohet sipas afatit kohor të përcaktuar në paragrin 4 të nenit 16 të UA të MMPH-së Nr.06/2017 dt.23.05.2017, pas marrjes së konfirmimit për pagesë.

X. Vlefshmëria e vendimit për caktimin e kushteve ndërtimore do të jetë një (1) vit, me mundësi të vazhdimit për një (1) vit tjeter, në rastet kur nuk ka ndërruar gjendja ekzistuese apo dokumenti i planifikimit hapësinor, dhe me aplikim para skadimit të afatit të vlefshmërisë.

A r s y e t i m

Aplikuesi Flamur Ajvazi, me kërkesën përiplikim me nr. 05-350/03-238415/19 dt. 27.09.2019, ka kërkuar nga Drejtoria e Urbanizmit e Komunës së Prishtinës, caktimin e kushteve ndërtimore përhartimin e dokumentacionit ndërtimor për ndërtimin e shtëpisë per banim individual me etazhitë B+P+1 në lokacionin e përshkruar si në pikën I të dispozitivit të këtyre Kushteve ndërtimore.

Bashkangjitur me kërkesë aplikuesit ka prezantuar: provën mbi të drejtën pronësoro-juridike në lokacionin në fjalë, për parcelat kadastrale nr. 00294-11 dhe 00294-12, të evidentuara në çertifikatat e njësive kadastrale P-71914075-00294-11 dhe P-71914075-00294-12 Z.K Çagllavicë të lëshuar nga Drejtoria e Kadastrit e Komunës së Prishtinës, kopja e letërnjoftimit e Flamur Ajvazit, vërtetimin e tatimit në pronë nr.91664432536 dt.23.07.2019 në emër të Flamur Ajvazi, Informimin nga Plani Rregullues “Prishtina e Re-Zona Perëndim”, me nr. të referencës 2353 të dt.24.07.2019, inçizimin gjeodezik për parcelat kadastrale nr. 00294-11 dhe 00294-12 të punuar nga gjeodeti i licencuar Milaim Dobratiqi me nr.të licencës 88 dt.08.05.2019, projekt propozimin përkushte ndërtimore, Pëlqimi LRP Nr.6200/2019 dt.19.07.2019 i Edon Ajvazit, pronar i parcelës kadastrale 00294-13 se fqi i tij Flamur Ajvazi mund të ndërtoi në distancë prej 1m nga kufiri i parceles. Projekti ideor i hartuar nga N.SH “Artech Studio” me numër të biznesit 70753006 dt.26.05.2011.

Flamur Ajvazi me kërkesen 05 nr. 350/02-189208/19 dt.02.08.2019 kishte kërkuar nga Drejtoria e Urbanizmit kushte ndërtimore për ndërtimin e shtëpisë me etazhitë B+P+1 në parcelat kadastrale 294-12 dhe 294-13 Z.K Prishtinë. Me vendimin 05nr.350/02-189208/19 dt.30.08.2019 kjo kërkesë është refuzuar pasi që aplikuesi nuk e ka plotësuar dokumentacionin brenda afatit të përcaktuar sipas nenit 21 pika 4 të Ligjit të Ndërtimit L-04/110 dt.31.05.2012.

Drejtoria e Urbanizmit e Komunës së Prishtinës pas shqyrimit të kësaj kërkesë përiplikim,plotësimin dhe ndryshimin e projektit konceptual ka konstatuar se propozimi përkushte

ndërtimore është konform kritereve të Planit Rregullues "Prishtina e Re-Zona Perëndim", i miratuar me Vendimin e Kuvendit Komunal me nr. 01 Nr. 35-186850 të dt. 02.10.2013, nenit 17 të Ligjit të Ndërtimit nr. 04/L-110 dt. 31.05.2012 si dhe nenit 7 të Udhëzimit Administrativ nr. 10/2013 për përcaktimin e procedurave për dorëzimin dhe shqyrtimin e kërkesave për kushte dhe leje ndërtimore.

Ky organ, pas shqyrtimit të kërkesës dhe provave tjera të bashkangjitura, konsultimit të planeve urbanistike për hapësirën ku gjendet lokacioni si dhe të rregullativës ligjore nga lëmi i ndërtimit dhe asaj nga lëmi i procedurës së përgjithshme administrative, konstatoi se, janë plotësuar të gjitha kriteret e parapara ligjore për lëshimin e këtyre Kushteve Ndërtimore.

Shtojcë: Shtojcë: Situacioni i parcelës ndërtimore me vijën ndërtimore dhe rregulluese nga Plani Rregullues në Sistemin Koordinativ KosovaRef01 dhe Plani i situacionit - "zgjidhja urbane",


Udhëzim juridik: Pala e pakënaqur me këto Kushte Ndërtimore, përmes kësaj Drejtorie me ankesë mund t'i drejtohet Ministrisë së Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor, brenda afatit prej 30 ditësh duke llogaritur nga dita e marrjes në dorëzim të këtyre Kushteve ndërtimore.

I dërgohet: Kërkuesit, kësaj Drejtorie, në dosjen e lëndës dhe Qendrës për shërbim me qytetarë.

**DREJTORIA E URBANIZMIT, E KOMUNËS SË PRISHTINËS,
NR. . 05-350/02-238415/19 DT. 24.01.2020**

Zyrtari,

Mejrushe Sejdullahu



u.d Udhëheqëse e Sektorit,

Mimoza (Berisha) Prestreshi






Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic Of Kosovo

Komuna e Prishtinës
Opstina Pristina - Municipality Of Prishtina



DREJTORIA E URBANIZMIT

SITUACIONI I PARCELAVE ME VIJEN NDERTIMORE DHE RREGULLUESE NGA PLANI RREGULLUES NE SISTEMIN KOORDINATIV KOSOVAREFO1



Punoi:
Kushtrim Domaneku.

Nënshkrimi :

Prishtinë: 09.08.2019

Legjenda:

- Riparcelimi sipas PRRU
- Vija Ndërtimore sipas PRRU
- Parcela kadastrale



SITUACIONI

S=1029.00 m²

"Prishtina e Re"- zona Perëndimore

Tërsia L, Blloku "L 18"

Parcella nr. 294-11 dhe 294-12

Sipërfaqja =1029.00 m²

Pronar: Flamur AJVAZI

ISHP- Indeksi i shfrytëzimit të parcellës 0.4 (40%) S=217 m² / 21.08 %


ISP -Indeksi i sip. se përgjithshme ndert. Max.450m² S=714 m² / B+P+1

ISHN -Indeksi i shfrytëzimit të nëntokës 60% S=285 m² / 27.69 %

ISGJ -Indeksi i sipërfaqës së gjelbrimit 25% S=600 m² / 58.30 %

Etazhitë maximal P+2 B+P+1

Sipërfaqja e llogaritur për banim P+1 / S=429 m²



- Konturat e shtepisë
- Mbulesa shtepisë
- Gjelbrimi
- Vija Ndertimore
- Vija Rregulluse
- Trotuari
- Vija rruges kryesore
- Gjendja Faktike
- Gjendja Kadastrale
- Objekte për rreth



PROJEKTI IDEOR 1

PRISHTINË - KOSOVË

Tipi i objektit dhe etazhitët	SHTËPI INDIVIDUALE B+P+1
-------------------------------	--------------------------

Përbajtja e Vizatimit	
-----------------------	--

VIZATOI:	ark.Adriatik BEQA	KONTROLLOI:	DATA: 21.01.2020
----------	-------------------	-------------	------------------

Përpjesa	P = 1 / 100
----------	-------------

NËNSHKRIMI:	VULA:
-------------	-------

Ngastra Urbane	"Prishtina e Re" - Zona Perëndimore
----------------	-------------------------------------

Sipërfaqe e shpëtusë bruto	217.00 m ²
----------------------------	-----------------------

KOMPANIJA	Arttech-Studio
-----------	----------------

Klienti	Flamur AJVAZI
---------	---------------

Adresa Komuna	Rr. Gasper Karaçi Prishtinë
---------------	--------------------------------

Nr. I gastrës	294-11 & 294-12	FORMATI:	A3 42.0/29.7
---------------	-----------------	----------	--------------

